



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31004-03723-80-2017 **Data e Regjistrimit :** 02/06/2017
Numri i Vendimit: 80-2017-3754 **Data e Vendimit :** 28/09/2017

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 28/09/2017mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites {...}, I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale

Objekti:Shfuqizimin e Vendimit nr. 51/5, date 15.03.2017 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale (DPPI) dhe detyrimin e Bordit te Apelimit per te mos kryer asnje veprim per regjistrimin e markes me numer aplikimi nderkombetar IR 230203 me aplikant {...}, n.p.,.

Baza Ligjore:Nenet 15, 17, 28, 29 dhe 30 te Ligjit nr. 49/2012, date 03.05.2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenet 143 dhe 152 te Ligjit nr. 9947 date 07.07.2008 “Per Pronesine Industriale” i ndryshuar, paragrafi 3, Kreu XVII i Vendimit te Keshiilit te Ministrave nr. 1706, date 29.12.2008 “Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit”.

pranimin e padise

VEREN :

Veren:

Pala paditese Shoqeria "{...}" i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, Tirane me padi kunder Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Intelektuale me objekt shfuqizimin e vendimit nr.51/5 dt.15.03.2017 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Intelektuale dhe detyrimin e pales se paditur per te mos kryer asnje veprim per regjistrimin e markes me numer aplikimi nderkombetar IR 230203 me aplikant {...}, n.p.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton e provuar se Shoqeria {...} eshte nje shoqeri e krijuar sipas legjislacionit te Shteteve te Bashkuara te Amerikes e themeluar, qe ne vitin 1925 ("Anheuser-Busch"), e cila ushtron veprimtarine e saj ne fushen e fabrikimit, prodhimit, tregtimit, import-eksportit te pijeve te ndryshme alkolike dhe jo alkolike, etj.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton e provuar se Shoqeria {...} ka rregjistruar ne Shqiperi, qe prej vitit 1970, Marken e saj "{...} Budvar", me numer rregjistrimi 1337, per mallrat e klases 31 dhe 32 te Klasifikimit te Nises dhe konkretisht per Malto (Kl.31) dhe Birre (kl.32) me afat te rinovuar te mbrojtjes deri me date 07.01.2020.

Shoqeria {...} me date 30.09.2004 ka kryer nje rregjistrim nderkombetar ne baze te marreveshjes se Madritit per marken "{...}" me nr rregjistrimi 835837, me afat mbrojtje deri me date 30.09.2014, per mallrat e klases 31 dhe 32 sipas Klasifikimit te Nises.

Shoqeria "{...}" n.p i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me kerkese padi per shfuqizimin e rregjistrimit ne Shqiperi te markes "Budwesier" te regjistruar me numer rregjistrimi nderkombetar nr.835837 dhe ndalimin e tregtimit te produkteve te shoqerise {...} ne marken 'Budwieser' ne tregun shqiptar. Me vendimin nr.6319 dt.19.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur pranimin e padise. Shfuqizimin ne Shqiperi te Markes "{...}"

rregjistruar nga i padituri me Nr.rregjistrimi nderkombetar me nr.835837 dhe ndalimi i tregtimit te produkteve te te paditurit me marken "Budwesier" ne tregun shqiptar. Me vendimin nr.3815 dt.20.11.2014 Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit nr.6319 dt.19.06.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Ky vendim eshte ekzekutuar sipas buletinit nr.1/2015 dt.19.03.2015.

Shoqeria {...} ka rregjistruar prane Organizates Boterore te Pronesise Industriale (WIPO) kerkesen per shtrirjen ne Shqiperi te rregjistrimit te markes "{...} Budvar" me nr.aplikimi 1156160, per mallrat e klases 32 te Klasifikimit te Nises "Birre".

Shoqeria "{...}" ka rregjistruar gjithashtu prane Organizates Boterore te Pronesise Industriale (WIPO) kerkesen per shtrirjen ne Shqiperi te rregjistrimit te markes "{...}" Birre te te gjitha llojeve". Shoqeria {...} ka kerkuar mbrojtjen ne Shqiperi te markave te mesiperme.

Me vendimin nr.13/5 dt.15.08.2014, Bordi i Apelimit Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave ka vendosur refuzimin e aplikimit per marken "{...}" me nr. aplikimi 238203, per mallrat e klases 32 te Klasifikimit te Nises, "Birre te te gjitha llojeve" sepse ajo krijon konfuzion me marken e rregjistruar ne favor te shoqerise {...} me nr.835837. Shoqeria {...} i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me kerkese per shfuqizimin e vendimit nr.13/5 dt.15.08.2014 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave. Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr.1117 dt.05.03.2015 ka vendosur rrezimin e kerkese padise. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendimin nr.1176 dt.28.05.2015 te Gjykates se Adminisrative te Apelit Tirane.

Me date 23.12.2014, Shoqeria Anheuser Bush ka rregjistruar marken "{...}" me nr aplikimi nr.1233145, per mallrat e klases 32 sipas klasifikimit te Nices.

Sipas aplikimit nr.2015/51 dt.31.12.2015, Shoqeria {...} ka kerkuar shtrirjen e mbrojtjes per marken "Buweiser" me nr aplikimi nderkombetar 238203, per mallrat e klases 32 te Klasifikimit te Nises, Birre.

Pasi ka marre dijeni per aplikimin e mesiperme, Shoqeria {...} ka paraqitur kundershtrimet e saj, duke pretenduar se aplikimi bie ne kundershtrim me te drejtat e fituara sipas rregjistrimeve nderkombetare nr.835837 dhe nr.1233145.

Me vendimin nr.51/5 prot dt.15.03.2017, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale ka vendosur rrezimin e kundershtrimit te rregjistrimit te markes "{...}" me numer aplikimi nderkombetar 238203 me aplikant shoqerine {...} dhe vijimin e procedures se saj. Ne vendimin e saj, pala e paditur ka vleresuar se me vendimin nr.3815 dt.20.11.2014 Gjykata e Apelit Tirane ka disponuar per crregjistrimin e markes "{...}" me nr aplikimi 835837 ne favor te Shoqerise {...} sepse eshte e ngjashme me marken "{...} Budvar" te rregjistruar nga shoqeria {...}. Marka kundershtruese "{...}" me nr. aplikimi nderkombetar nr.1233145 eshte identike me marken e crregjistruar nr aplikimi 835837 dhe eshte rregjistruar pas rregjistrimit te markes nr.835837, e cila eshte crregjistruar me vendim gjykate.

Ne keto kushte pala paditese i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane me padine e mesiperme. Pala paditese pretendon se rregjistrimi i markes "{...}" ne favor te personit te trete {...}, n.p eshte ne konflikt me te drejtat e meparshme te paditesit te rregjistruar me nr. IR1233145, me te njejtin emer dhe klase

produktesh. Pala paditese ka rregjistruar marken "Buweiser" me numer rregjistrimi nderkombetar IR1233145 eshte 21.12.2014 me date priorireti 26.06.2014. Shoqeria {...} ka tentuar edhe me pare qe te shtrije mbrojtjen mbi aplikimin nr.238203, por kjo kerkese eshte refuzuar nga pala e paditur dhe eshte ky qendrim eshte konfirmuar edhe nga gjykata. Vendimi nr.3815 dt.20.11.2014 I Gjykates se Apelit Tirane, nuk trajton konfliktin mes shtrirjes per mbrojtje te markes nr.238203

me rregjistrimin e meparshem te shoqerise {...} e aq me pak konflikte mes markes me numer rregjistrimi nr.238203 te shoqerise {...}, n.p me aplikimin me rregjistrimi nr. IR1233145 ne favor te shoqerise {...}.

Personi i trete, Shoqeria {...} pretendon se marka "{...}" me numer nderkombetar 238203 eshte rregjistruar ne rruge nderkombetare qe prej vitit 1960. Ne Shqiperi, Shoqeria {...} ka rregjistruar marken "{...} Budvar", qe prej vitit 1970, me numer aplikimi 1337, duke perfshire produktin Birre, klasa 32 me afat vlefshmerie deri me daten 07.01.2020. Me vendimin nr.3815 date 20.11.2014, Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur qe te crregjistroje

marken "Buweiser" ne favor te shoqerise {...}, me nr rregjistrimi nderkombetar 835837,

vendim i cili eshte ekzekutuar teresisht duke crregjistruar marken e mesiperme. Gjate kohes qe ka qene ne procedure crregjistrimi i markes "{...}" me nr rregjistrimi 835837, pala paditese, Shoqeria {...} ka aplikuar me date 23.12.2014 dhe ka rregjistruar marken "{...}" me nr. nderkombetar 1233145. Pavaresisht veprimeve ne

keqbesim te drejta e Shoqerise {...} jane me te meparshme ndaj te drejtave te {...}, si

ne nivel nderkombetar ne baze te sistemit te Madridit ashtu edhe ne nivel kombetar nepermjet

rregjistrimit te markes nr 1337 prane regjistrimit Shqiptar te markave qe prej vitit 1970, fakt qe eshte

konfirmuar nga vendimi nr.3815 dt.20.11.2014 I Gjykates se Apelit Tirane. Rregjistrimi i markes "{...}" nga pala paditese me nr aplikimi 1233145 eshte ne kundersizim me ligjin pasi cenon te drejta e personit te trete sipas aplikimit nr.1337 te

vitit 1970. Pretendimi i pales paditese se me vendimin nr.13/5 dt.15.08.2014, Bordi I Apelimit ka pranuar kundersizimin per shtrirjen e mbrotjes per marken nr.238203 nuk qendron sepse si bordi I Apelimit, ashtu edhe gjykata I jane referuar faktit se ne

kohen e marrjes se vendimit nr.13/5 dt.15.08.2014, vendimi nr.3815 dt.20.11.2014 I Gjykates se Apelit Tirane per

crregjistrimin e markes ende ishte marre dhe ne keto kushte vendimi nuk kishte marre forme te prere.

Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi ceshtjen arriti ne konkluzionin se kerkese padia eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille ajo duhet rrezuar.

Konform nenit 143 te ligjit nr 9947 date 07.07.2008, *Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur: a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme; b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme; c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kur eshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republiken e Shqiperise dhe perdorimi ose rregjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet te padrejte ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme.*

Duke iu referuar rastit konkret, gjykata vlereson se shoqeria "{...}" gezon te drejta te meparshme te mbrojtura ne Shqiperi ne lidhje me marken "{...} Budvar", te drejta te rregjistruara sipas aplikimit nr.1337 te vitit 1970. Ne lidhje me konfliktin se cila nga palet gezon te drejten e mbrojtjes se markes, mes markes "{...} Budvar" ne favor te

shoqerise {...} dhe markes "{...}" ne favor te shoqerise {...}, Gjykata e Apelit

Tirane me vendimin nr.3815 date 20.11.2014 ka vendosur qe e drejta e mbrojtjes i takon Shoqerise

{...} dhe markes "{...} Budvar" duke vendosur crregjistrimin e markes "{...}" me nr aplikimi

835837 ne favor te shoqerise {...}.

Konform nenit 451 te Kodit te Procedures Civile, *vendimi qe ka marre forme te prere eshte i detyrueshem per palet, per trashegimtarete e tyre, per personat qe heqin te drejta nga palet, per gjykatat qe ka dhene vendimin dhe per te gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi qe ka marre forme te prere ka fuqi vetem per gja eshte vendosur midis po atyre paleve, per te njejtin objekt dhe per te njejtin*

shkak. Ne keto kushte, kjo gjykate vlereson se vendimi nr.3815 date 20.11.2014 i Gjykates se Apelit Tirane eshte i detyrueshem si per palet ne gjykim edhe per gjykatën. Ne kete kuptim, gjykata vlereson se vendimi nr.3815 date 20.11.2014 ka percaktuar ne menyre perfundimtare se Marka "{...}" ne favor te shoqerise {...} nuk gezon mbrojtje ne Shtetin Shqiptar. Rregjistrimi i Markes "{...}" ne favor te shoqerise {...} me nr aplikimi 1233145 me dt 21.12.2014 dhe date prioriteti 26.06.2014, eshte identik me rregjistrimin e markes "{...}" ne favor te shoqerise {...} me nr aplikimi 835837, sepse behet fjale per te njejten marke dhe per te njejtin produkt. Gjukata vlereson se pavaresisht se kur eshte rregjistruar marka me nr aplikimi. 1233145, vendimi nr.3815 date 20.11.2014 i Gjykates se Apelit Tirane ka percaktuar se te drejtat mbi marken "{...}" nuk mund te mbrohen nga pala paditese shoqerise {...} ne Shqiperi. Ne lidhje me rastin konkret, gjykata mban parasysh se rregjistrimi i Markes "{...}" me nr aplikimi 1233145 ne favor te pales paditese eshte nje rregjistrim i mevonshem ne kohe se rregjistrimi 835837 dhe eshte identik me te, dhe ne lidhje me konfliktin mes ketyre dy markave Gjukata e Apelit Tirane me vendimin nr.3815 date 20.11.2014 ka vendosur qe marka "{...}" ne favor te paditesit nuk mund te mbrohet ne Shqiperi. Gjukata e gjen te pabazuar pretendimin e pales paditese se kerkesa e shoqerise {...} per rregjistrimin e markes 238203 eshte refuzuar edhe me pare nga pala e paditur dhe ky qendrim eshte lene ne fuqi edhe ne rruge gjyqesore. Gjukata konstaton se ne rastin konkret, gjykatat kane lene ne fuqi vendimin e pale se paditur nr.13/5 dt.15.08.2014, per te refuzuar aplikimin per arsye se rregjistrimi nr.835837 ne favor te pales paditese ka qene ende ne fuqi dhe se konflikti se cila marke gjente mbrojtje ne Shqiperi nuk ishte zgjidhur ende me vendim gjyqesor te formes se prere. Ne momentin qe gjykata ka vendosur se rregjistrimi i markes "{...}" ne favor te shoqerise {...} nuk gjen mbrojtje ne Shqiperi asgje nuk e pengon shoqerine {...} te rregjistroje marken "{...}". Ne keto kushte gjykata cmon se vendimi i pales se paditur per te refuzuar kundershkrimin e pales paditese eshte i drejte dhe i bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille kerkese padia duhet rrezuar.

PER KETO ARSYE

Gjukata, bazuar ne nenin 40 te ligjit nr.49/2012

Per keto arsye

Baza Ligjore:.

VENDOSI:

Vendosi:Rrezimin e kerkese padise.

- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales paditese.
 - Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Administrative Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpaljes. Per palet ne mungese ky afat fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit.
- U shpall sot me dt. 28.09.2017.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}